



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr.462, datë 19.10.2020**

**PËR**  
**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË NGRITJES**  
**NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR TRE POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË**  
**DREJTËS PENALE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 241, NR. 242 DHE NR. 243,**  
**DATË 09.07.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja e saj, znj. Marçela Shehu,

**VENDOSI:**

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 243 datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Vendimi nr. 331, datë 17.09.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**